

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Menaxhimi i Performancës

P8

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data
Date

12.02.2022

Problemi 1

Kompania 'Out-tel' bënë prodhimin e SSD-ve (Solid State Drive - njësi kompjuterike për deponimin e qëndrueshëm të të dhënave) që përdorë qarqe të integruara për të ruajtur të dhënat në mënyrë të vazhdueshme, zakonisht duke përdorë 'flash memorie' dhe duke funksionuar si deponi dytësore në hierarkinë e ruajtjes/deponimit kompjuterik të të dhënave.

Novatorët e kompanisë janë duke zhvilluar SSD me hapësirë të madhe deponimi të të dhënave me emrin XL-SSD për të cilin besojnë që do të ketë kërkesë nga secili prodhues i laptop-ëve.

Në bashkëpunim me kontabilistin menaxherial të kompanisë kanë përgatitur dhe prezantuar menaxhmentit të kompanisë të dhënat e vlerësuara për 3 vitet e ardhshme:

		<u>Viti I</u>	<u>Viti II</u>	<u>Viti III</u>
Njësitë të XL-SSD të prodhuar dhe shitur	njësi	500,000	1,250,000	1,000,000
Çmimi i XL-SSD për njësi	€	18	15	12
Kostoja e zhvillimit	€	650,000	100,000	-
<u>Kosto të prodhimitarisë:</u>				
Njësi të XL-SSD për grup (në prodhimtari)	njësi	400	500	500
Kosto variabile të prodhimitarisë për njësi	€	5	4	3
Kosto variabile të prodhimitarisë për grup	€	600	500	500
Kosto fikse të prodhimitarisë	€	400,000	400,000	400,000
<u>Kosto të marketingut:</u>				
Kosto variabile të marketingut për njësi	€	3	2.8	2.6
Kosto fikse të marketingut	€	250,000	200,000	200,000
<u>Kostot e shpërndarjes:</u>				
Njësi të XL-SSD për grup (në shpërndarje)	njësi	200	125	100
Kosto variabile të shpërndarjes për njësi	€	1	1	1
Kosto variabile të shpërndarjes për grup	€	360	225	150
Kostot fikse të shpërndarjes	€	230,000	230,000	230,000
Shpenzimet e promovimit të shitjeve për njësi	€	2	1.5	1.5

Kërkohet:

1. Të llogaritet fitimi i kompanisë 'Out-tel' përgjatë ciklit jetësor të produktit XL-SSD. **11 pikë**
2. Menaxheri i shitjeve propozon uljen e çmimit të shijes për nga €1.00 për secilin vit të ciklit jetësor të produktit XL-SSD, që do të ndikonte që shitjet e secilës periudhë të rriteshin për 25%. Në këtë rast numri i njësi në grupin e prodhimitarisë do të rritej gjithashtu për 25% ndërsa numri i njësi në grupin për shpërndarje do të rritet për 20%. Të llogaritet fitimi i kompanisë 'Out-tel' përgjatë ciklit jetësor të produktit XL-SSD bazuar në propozimin e Menaxherit të shitjeve. Komentoni rezultatet e arritura në pikën 1. dhe pikën 2. **9 pikë**

Zgjidhja

a. Llogaritja e fitimit për gjatë ciklit jetësor të produktit

	<u>Viti I</u>	<u>Viti II</u>	<u>Viti III</u>	<u>Cikli i jetës</u>
	<u>në €(.000)</u>	<u>në €(.000)</u>	<u>në €(.000)</u>	<u>në €(.000)</u>
Shitjet	9,000	18,750	12,000	39,750
Kostoja e zhvillimit	650	100		750
Kostot e prodhimit:				
<i>KV të prodhimit për njësi</i>	2,500	5,000	3,000	10,500
<i>KV të prodhimit për grupe</i>				
$(500,000 \div 400) \times 600$	750			750
$(1,250,000 \div 500) \times 500$		1,250		1,250
$(1,000,000 \div 500) \times 500$			1,000	1,000
<i>Kostot fikse</i>	400	400	400	1,200
Kostot e marketingut:				
<i>KV të marketingut për njësi</i>	1,500	3,500	2,600	7,600
<i>Kostot fikse të marketingut</i>	250	200	200	650
Kostot e Shpërndarjes:				
<i>KV të shpërndarjes për njësi</i>	500	1,250	1,000	2,750
<i>KV të shpërndarjes për grupe</i>				
$[(500,000 \div 200) \times 360]$	900			900
$[(1,250,000 \div 125) \times 225]$		2,250		2,250
$[(1,000,000 \div 100) \times 150]$			1,500	1,500
<i>Kostot fikse të shpërndarjes</i>	230	230	230	690
Shpenzimet e promovimit të shitjeve	<u>1,000</u>	<u>1,875</u>	<u>1,500</u>	<u>4,375</u>
Kostoja totale	<u>8,680</u>	<u>16,055</u>	<u>11,430</u>	<u>36,165</u>
Fitimi	320	2,695	570	3,585

11 pikë

b. Llogaritja e fitimit për gjatë ciklit jetësor të produktit bazuar në propozimin e menaxherit të shitjes

Llogaritjet ndihmëse (të dhënat e ri-shikuara bazuar në propozimin e menaxherit të shitjes):

	<u>Viti I</u>	<u>Viti II</u>	<u>Viti III</u>
Çmimet e rishikuara të shitjes (të zvogëluara për €1.00)	€17.00	€14.00	€11.00
Numri i njësive për shitje (i rritur për 25%)	625,000	1,562,500	1,250,000
Numri i njësive në grupin e prodhimtarisë (i rritur për 25%)	500	625	625
Numri i njësive në grupin për shpërndarje (i rritur për 20%)	240	150	120

	<u>Viti I</u>	<u>Viti II</u>	<u>Viti III</u>	<u>Cikli i jetës</u>
	<u>në €(.000)</u>	<u>në €(.000)</u>	<u>në €(.000)</u>	<u>në €(.000)</u>
Shitjet	10,625.00	21,875.00	13,750.00	46,250.00
Kostoja e zhvillimit	650.00	100.00		750.00
Kostot e prodhimit:				
<i>KV të prodhimit për njësi</i>	3,125.00	6,250.00	3,750.00	13,125.00
<i>KV të prodhimit për grupe</i>				
$(625,000 \div 500) \times 600$	750.00			750.00
$(1,562,500 \div 625) \times 500$		1,250.00		1,250.00
$(1,250,000 \div 625) \times 500$			1,000.00	
<i>Kostot fikse</i>	400.00	400.00	400.00	1,200.00
Kostot e marketingut:				
<i>KV të marketingut për njësi</i>	1,875.00	4,375.00	3,250.00	9,500.00
<i>Kostot fikse të marketingut</i>	250.00	200.00	200.00	650.00
Kostot e Shpërndarjes:				
<i>KV të shpërndarjes për njësi</i>	625.00	1,562.50	1,250.00	3,437.50
<i>KV të shpërndarjes për grupe</i>				
$[(625,000 \div 240) \times 360]$	937.50			937.50
$[(1,562,500 \div 150) \times 225]$		2,343.75		2,343.75
$[(1,250,000 \div 120) \times 150]$			1,562.50	1,562.50
<i>Kostot fikse të shpërndarjes</i>	230.00	230.00	230.00	690.00
Shpenzimet e promovimit të shitjeve	<u>1,250.00</u>	<u>2,343.75</u>	<u>1,875.00</u>	<u>5,468.75</u>
<i>Kostoja totale</i>	<u>10,092.50</u>	<u>19,055.00</u>	<u>13,517.50</u>	<u>42,665.00</u>
Fitimi	532.50	2,820.00	232.50	3,585.00

8 pikë

Fitimi i ciklit jetësor të Produktit XL-SSD sipas skenarit fillestar është në vlerë prej €3,585,000. Pas shqyrtimit dhe llogaritjeve të bëra bazuar në propozimin e menaxherit të shitjeve arrihet te vlera e fitimit prej €3,585,000, vlerë e barabartë prej nga rrjedh se efekti i përgjithshëm i dy skenarëve është i barabartë me €0 (€3,585,000 - €3,585,000).

1 pikë

Problemi 2

- a. Menaxhmenti i kompanisë INN duhet të zgjedhë njërin nga pesë projekteve reciprokisht përjashtuese. Secili projekt do të zgjas një vit dhe rrjedhjet hyrëse neto të parasë së gatshme nga projekti përcaktohen nga kushtet mbizotëruese të kërkesës. Probabilitetet e kërkesës dhe parashikimet e rrjedhjeve hyrëse neto të parasë së gatshme që ndërlidhen janë paraqitur në vazhdim:

<u>Kërkesa</u>	<u>e dobët</u>	<u>e moderuar</u>	<u>e fortë</u>
<u>Probabiliteti i kërkesës</u>	0.15	0.50	0.35
<u>Projekti</u>	<u>Rrjedhjet hyrëse neto të PG bazuar në llojin e kërkesës</u>		
Projekti A	145,000	125,000	165,000
Projekti B	115,000	155,000	160,000
Projekti C	105,000	120,000	150,000
Projekti D	100,000	130,000	110,000
Projekti E	160,000	140,000	125,000

Kërkohet:

- i. Çfarë do të jetë vendimi i menaxhmentit të kompanisë INN, bazuar në vlerat e pritura, në qoftë se nuk ka të dhëna në dispozicion në lidhje me kërkesën? **6 pikë**
- ii. Llogaritni vlerën e të dhënave të përsosura në lidhje me kërkesën. **4 pikë**
- b. Menaxhmenti i departamentit të shitjes i kompanisë INN është bërë gati të lëshojë për tregtim produktin më të ri të kompanisë të quajtur cronOmi. Parashikimet e shijeve vjetore dhe probabilitetet respektive janë të paraqitura në vazhdim:

<u>Shitjet vjetore (€)</u>	<u>Probabiliteti</u>
450,000	0.10
550,000	0.20
650,000	0.40
750,000	?
850,000	?

Probabilitet për shitjet e parashikuara në vlerë prej €750,000 dhe €850,000 janë të barabarta. Sipas politikave të përcaktuara të kompanisë raporti minimal i pranueshëm i kontributit ndaj shitjeve (koeficienti K/Sh) duhet të jetë 30%. Kosto fikse tremujore të kompanisë janë parashikuar në vlerën prej €39,000.

Kërkohet:

- i. Të llogaritet vlera e pritur (VP) e neto fitimit vjetor të kompanisë nga produkti cronOmi. **7 pikë**
- ii. Të llogaritet vlera e të hyrave e cila duhet të realizohet nga shitja e produktit cronOmi për arritjen e pikës e rentabilitetit. Të llogaritet vlera e shitjeve të produktit cronOmi e cila duhet të realizohet për arritjen e neto fitimit vjetor në vlerë prej €55,500. **3 pikë**

Zgjidhja

a.i. Llogaritja e Vlerës së Pritur (VP) për secilin projekt

	<u>Kërkesa</u>	<u>Probabiliteti</u>	<u>Rrjedhja e PG</u>	<u>Vlera e pritur</u>
Projekti A	e dobët	0.15	145,000	21,750
	e moderuar	0.50	125,000	62,500
	e fortë	0.35	165,000	<u>57,750</u>
				142,000

1 pikë

	<u>Kërkesa</u>	<u>Probabiliteti</u>	<u>Rrjedhja e PG</u>	<u>Vlera e pritur</u>
Projekti B	e dobët	0.15	115,000	17,250
	e moderuar	0.50	155,000	77,500
	e fortë	0.35	160,000	<u>56,000</u>
				150,750

1 pikë

	<u>Kërkesa</u>	<u>Probabiliteti</u>	<u>Rrjedhja e PG</u>	<u>Vlera e pritur</u>
Projekti C	e dobët	0.15	105,000	15,750
	e moderuar	0.50	120,000	60,000
	e fortë	0.35	150,000	<u>52,500</u>
				128,250

1 pikë

	<u>Kërkesa</u>	<u>Probabiliteti</u>	<u>Rrjedhja e PG</u>	<u>Vlera e pritur</u>
Projekti D	e dobët	0.15	100,000	15,000
	e moderuar	0.50	130,000	65,000
	e fortë	0.35	110,000	<u>38,500</u>
				118,500

1 pikë

	<u>Kërkesa</u>	<u>Probabiliteti</u>	<u>Rrjedhja e PG</u>	<u>Vlera e pritur</u>
Projekti E	e dobët	0.15	160,000	24,000
	e moderuar	0.50	140,000	70,000
	e fortë	0.35	125,000	<u>43,750</u>
				137,750

1 pikë

Rekapitullimi

<u>Projekti</u>	<u>Vlera e pritur</u>	<u>Renditja</u>
A	€142,000	2
B	€150,750	1
C	€128,250	4
D	€118,500	5
E	€137,750	3

Rregulli i vendimit i vlerës së pritshme (VP) është se, alternativa e vendimit me VP më të lartë të përfitimit duhet të zgjidhet. Për të ndihmuar vendimin i njëjti parim vlen edhe në rastet kur nuk ka asnjë të dhënë. Në këtë rast **Projekti B** ka VP më të lartë të përfitimit të rrjedhjes hyrëse të PG në vlerë **€150,750** andaj edhe duhet përzgjedhur.

1 pikë

a.ii. Llogaritja e Vlerës së Pritur (VP) e të dhënave të përsosura

Me të dhënat e përsosura, alternativa më e mirë e vendimit gjithmonë do të përzgjidhet, andaj në këtë rast për secilën alternativë të kërkesës përzgjidhet projekti me rrjedhjen hyrëse më të lartë të parasë së gatshme.

<u>Kërkesa</u>	<u>e dobët</u>	<u>e moderuar</u>	<u>e fortë</u>
<u>Probabiliteti i kërkesës</u>	0.15	0.50	0.35
<u>Projekti</u>	<u>Rrjedhjet hyrëse neto të PG bazuar në llojin e kërkesës</u>		
Projekti A	145,000	125,000	165,000
Projekti B	115,000	155,000	160,000
Projekti C	105,000	120,000	150,000
Projekti D	100,000	130,000	110,000
Projekti E	160,000	140,000	125,000

Nëse kërkesa është ...

<u>Kërkesa</u>	<u>Probabiliteti</u>	<u>Projekti i zgjedhur</u>	<u>Rrjedhja e PG</u>	<u>VP</u>
... e dobët	0.15	Projekti E	160,000	€24,000
... e moderuar	0.50	Projekti B	155,000	€77,500
... e fortë	0.35	Projekti A	165,000	<u>€57,750</u>
VP e rrjedhjes hyrëse të PG me të dhëna të përsosura				€159,250
VP e rrjedhjes hyrëse të PG kur nuk ka asnjë të dhënë (a.i.)				<u>€150,750</u>
Vlera e të dhënave të përsosura				€8,500

4 pikë

b.i. Llogaritja e vlerës së pritur (VP) të neto fitimit vjetor

- Përcaktimi i probabiliteteve për shitjet e parashikuara në vlerë prej €750,000 dhe €850,000
- Së pari, duhet të gjinden probabilitetet për shitjet e parashikuara në vlerë prej €750,000 dhe €850,000. Meqenëse nivelet e shitjeve të dhëna janë parashikuar të jenë rezultatet e vetme të mundshme, shuma e probabiliteteve të tyre duhet të jetë e barabartë me 1.

<u>Shitjet vjetore (€)</u>	<u>Probabiliteti</u>
450,000	0.10
550,000	0.20
650,000	0.40
750,000	?
850,000	<u>?</u>
	1.00

$$\begin{aligned} \text{prej nga rrjedh se shuma e probabilitetit për dy alternativat e fundit} &= 1.00 - (0.10 + 0.20 + 0.40) \\ &= 1.00 - 0.70 \\ &= \mathbf{0.30} \end{aligned}$$

Meqenëse probabilitetet e këtyre dy alternativave janë të barabarta, probabilitetet individuale të tyre janë:

$$\begin{aligned} \text{Probabilitetet individuale për shitjet prej €750,000 dhe €850,000} &= 0.30 \div 2 \\ &= \mathbf{0.15} \end{aligned}$$

2 pikë

- Llogaritja e vlerës së pritur (VP) të shitjeve të parashikuara

<u>Shitjet vjetore (€)</u>	<u>Probabiliteti</u>	<u>Vlera e pritur (VP)</u>
450,000	0.10	€45,000
550,000	0.20	€110,000
650,000	0.40	€260,000
750,000	0.15	€112,500
850,000	<u>0.15</u>	<u>€127,500</u>
	1.00	€655,000

3 pikë

- Llogaritja e vlerës së pritur (VP) të neto fitimit vjetor

VP e kontributit	$655,000 \times 30\%$	€196,500
Kostot fikse vjetore	$39,000 \times 4$	<u>€156,000</u>
VP e neto fitimit vjetor		€40,500

2 pikë

- b.ii.** Llogaritja e vlerës së të hyrave për arritjen e pikës e rentabilitetit.

Formula: të hyrat nga shitja për PR = Kostot fikse ÷ koeficienti K/Sh
 = $(4 \times 39,000) \div 30\%$
 = $€156,000 \div 30\%$
 = **€520,000**

1.5 pikë

Llogaritja e vlerës së shitjeve të për arritjen e neto fitimit vjetor në vlerë prej €55,500

Formula: të hyrat nga shitja për PR = (Kostot fikse + Fitimi i synuar) ÷ koeficienti K/Sh
 = $(€156,000 + 55,500) \div 30\%$
 = $€211,500 \div 30\%$
 = **€705,000**

1.5 pikë

Problemi 3

Të dhënat standarde për njësi të produktit A janë si më poshtë:

	<u>€ për njësi</u>	<u>€ për njësi</u>
Çmimi standard i shitjes		12.00
Kostoja e punës direkte	3.00	
Kostoja e materialit direkt	3.60	
ShPP variabile	<u>0.30</u>	
Kosto variabile e prodhimit		<u>6.90</u>
Kontributi standard		5.10
ShPP fikse		<u>2.00</u>
Fitimi standard		3.10

Vëllimi i buxhetuar i prodhimit dhe shitjeve për Produktin A ishte 6,000 njësi, ndërsa orët e buxhetuara të punës direkte për prodhimin e këtyre njësive ishin 3,600 orë me një normë standarde të PD prej €5.00 për orë.

Përdorimi standard i materialit direkt për prodhimin e një njësie të Produktit është 1.20 kg. me kosto standarde prej €3.00 për kg. ShPP fikse e buxhetuar ishte në vlerën prej €12,000, ndërsa ShPP variabile e buxhetuar për njësi ishte €0.50.

Gjatë raportimit të rezultateve aktuale për periudhën e njëjtë u kuptua se janë prodhuar 5,750 njësi të Produktit A për të cilat janë paguar €20,930 për 4,025 orë të punuara, ndërsa janë blerë dhe përdorur 7,475 kg. të materialeve direkte me çmim prej €2.80 për kg. Në këtë proces të prodhimit janë shkaktuar ShPP në vlerë totale prej €14,260 prej të cilave ShPP fikse ishte në vlerë prej €12,650.

Gjatë periudhës nga shitja e 5,250 njësive të Produktit A janë gjeneruar të hyrat në vlerë prej €65,625. Kompania i vlerëson stoqet e produkteve të saja sipas koston standarde të prodhimit.

Kërkohet

Përgatitni pasqyrat operative e cila do të bëjë harmonizimin e fitimit standard dhe fitimit aktual për periudhën duke përdorur:

- koston standarde për vetësuesen (ku për ShPP-të duhet të tregoni mospërputhjet e shpenzimit dhe të efikasitetit të ShPP-së variabile dhe mospërputhjet e shpenzimit dhe të vëllimit të ShPP-së fikse) dhe **13 pikë**
- koston standarde marxhinale. (*Ndihmesë:* Te sistemi i koston marxhinale mospërputhja e vetme e ShPP-së fikse është mospërputhja e shpenzimit të ShPP-së fikse, ndërsa vlera e mospërputhjes së vëllimit të shitjes llogaritet duke përdorur kontributin standard). **5 pikë**
- Llogaritni dallimin eventuale të fitimeve aktuale sipas këtyre dy metodave duke shpjeguar arsyet se pse mund të paraqitet ky dallim. **2 pikë**

Zgjidhja

a. Pasqyra operative sipas kostos standarde përvetësuese

- Llogaritja e mospërputhjeve

Mospërputhjet e materialeve direkte

Mospërputhja e çmimit të MD

Sasia e MD aktuale sipas çmimit standard është dashur të kushtojë $(7,475 \times 3.00)$	22,425
Por ka kushtuar $(7,475 \times 2.80)$	<u>20,930</u>
Mospërputhja e çmimit të MD	1,495 F

Mospërputhja e përdorimit të MD

Prodhimtaria aktuale sipas përdorimit standard është dashur të përdorë $(5,750 \times 1.20)$	6,900
Por ka përdorur	<u>7,475</u>
Mospërputhja e përdorimit të MD në kilogram	575 PF
× Çmimi standard për kilogram	× <u>3.00</u>
Mospërputhja e përdorimit të MD në €	1,725 PF

2 pikë

Mospërputhjet e punës direkte

Mospërputhja e normës së PD

Orët aktuale të PD sipas normës standarde është dashur të kushtojë $(4,025 \times 5.00)$	20,125
Por ka kushtuar	<u>20,930</u>
Mospërputhja e normës së PD	805 PF

Mospërputhja e efikasitetit të PD - Koha standarde për njësi = $3,600 \text{ orë} \div 6,000 \text{ njësi} = 0.60 \text{ orë}$

Prodhimtaria aktuale sipas kohës standarde është dashur të zgjasë $(5,750 \div 0.60)$	3,450
Por ka përdorur	<u>4,025</u>
Mospërputhja e efikasitetit të PD në njësi fizike (orë)	575 PF
× Norma standarde për orë	× <u>5.00</u>
Mospërputhja e efikasitetit në €	2,875 PF

2 pikë

Mospërputhjet e ShPP-së variable

Mospërputhja e shpenzimit të ShPP-së variable

Orët aktuale të PD sipas normës standarde është dashur të kushtojë $(4,025 \times 0.50)$	2,012.50
Por ka kushtuar	<u>1,610.00</u>
Mospërputhja e shpenzimit të PD	402.50 F

Mospërputhja e efikasitetit të PD - Koha standarde për njësi = $3,600 \text{ orë} \div 6,000 \text{ njësi} = 0.60 \text{ orë}$

Prodhimtaria aktuale sipas kohës standarde është dashur të zgjasë $(5,750 \div 0.60)$	3,450.00
Por ka përdorur	<u>4,025.00</u>
Mospërputhja e shpenzimit të ShPP-së variable në njësi fizike (orë)	575.00 PF
× Norma standarde për orë	× <u>0.50</u>
Mospërputhja e shpenzimit të ShPP-së variable në €	287.50 PF

2 pikë

Mospërputhjet e ShPP-së fikseMospërputhja e shpenzimit të ShPP-së fikse

ShPP fikse e buxhetuar	12,000
ShPP fikse aktuale	<u>12,650</u>
Mospërputhja e shpenzimit të PD	650 PF

Mospërputhja e vëllimit të ShPP-së fikse

Vëllimi i buxhetuar në njësi	6,000
Vëllimi aktual	<u>5,750</u>
Mospërputhja e vëllimit të ShPP-së fikse në njësi	250 PF
× Norma standarde e ShPP-së fikse (€12,000 ÷ 6,000 njësi)	× <u>2.00</u>
Mospërputhja e vëllimit të ShPP-së fikse në €	500 PF

2 pikë

Mospërputhjet e shitjeveMospërputhja e çmimit të shitjes

Shitjet aktuale (njësi) me çmim standard të shitjes duhej të gjenerojnë (5,250 × 12)	63,000
Por kanë gjeneruar	<u>65,625</u>
Mospërputhja e çmimit të shitjes	2,625 F

Mospërputhja e vëllimit të shitjes

Vëllimi i buxhetuar i shitjes	6,000
Vëllimi aktual i shitjes	<u>5,250</u>
Mospërputhja e vëllimit të shitjes në njësi	750 PF
× Fitimi standard për njësi	× <u>3.10</u>
Mospërputhja e vëllimit të shitjes në €	2,325 PF

2 pikë

- Pasqyra e operacioneve sipas sistemit përvetësues së kostos

Fitimi i buxhetuar		6,000 × 3.10	18,600	
Mospërputhjet e shitjeve	<u>Pafavorshme</u>	<u>Favorshme</u>		
Mospërputhja e çmimit të shitjes		2,625.00		
Mospërputhja e vëllimit të shitjes	<u>2,325.00</u>	_____	<u>300</u>	F
			18,900	
Mospërputhjet e kostove	<u>Pafavorshme</u>	<u>Favorshme</u>		
Mospërputhja e çmimit të MD		1,495.00		
Mospërputhja e përdorimit të MD	1,725.00			
Mospërputhja e normës së PD	805.00			
Mospërputhja e efikasitetit të PD	2,875.00			
Mospërputhja e shpenzimit të ShPP-së variable		402.50		
Mospërputhja e efikasitetit të ShPP-së variable	287.50			
Mospërputhja e shpenzimit të ShPP-së fikse	650.00			
Mospërputhja e vëllimit të ShPP-së fikse	<u>500.00</u>	_____		
Totali i mospërputhjeve të kostove	6,842.50	1,897.50	<u>4,945</u>	PF
Fitimi aktual			13,955	

3 pikë

b. Pasqyra e operacioneve sipas sistemit marxhinal së kostos

Fitimi i buxhetuar		6,000 × 3.10	18,600	
Kostot e buxhetuara fikse të prodhimitarisë			<u>12,000</u>	
Kontributi i buxhetuar			30,600	
Mospërputhjet e shitjeve	<u>Pafavorshme</u>	<u>Favorshme</u>		
Mospërputhja e çmimit të shitjes		2,625.00		
Mospërputhja e vëllimit të shitjes (750 × 5.10)	<u>3,825.00</u>	_____	<u>1,200</u>	PF
			29,400	
Mospërputhjet e kostove	<u>Pafavorshme</u>	<u>Favorshme</u>		
Mospërputhja e çmimit të MD		1,495.00		
Mospërputhja e përdorimit të MD	1,725.00			
Mospërputhja e normës së PD	805.00			
Mospërputhja e efikasitetit të PD	2,875.00			
Mospërputhja e shpenzimit të ShPP-së variable		402.50		
Mospërputhja e efikasitetit të ShPP-së variable	<u>287.50</u>	_____		
Totali i mospërputhjeve të kostove variable	5.692.50	1,897.50	<u>3,795</u>	PF
Kontributi aktual			25,605	
Kostot e buxhetuara fikse të prodhimitarisë	12,000.00			
Mospërputhja e shpenzimit të ShPP-së fikse	650.00			
ShPP aktuale fikse			<u>12,650</u>	
Fitimi aktual			12,955	

5 pikë

c. Llogaritja e dallimit të fitimeve aktuale në mes të kostos përvetësuese dhe kostos marxhinale

Fitimi aktual sipas kostos përvetësuese	€13,955	
Fitimi aktual sipas kostos marxhinale	<u>€12,955</u>	
Dallimi në fitimet aktuale	€1,000	<i>në favor të kostos përvetësuese</i>

Dallimi në fitimet aktuale në vlerë prej €1,000 paraqitet për shkak të dallimit në trajtimin e ShPP-së fikse në koston e prodhimitarisë respektivisht vlerësimin e stoqeve përfundimtare. Metoda e kostos përvetësuese e llogaritë pjesën e ShPP-së fikse në koston e prodhimitarisë respektivisht e bartë pjesën e kostos së ShPP-së fikse në stoqet përfundimtare të produkteve të gatshme (në bilancin e gjendjes), derisa metoda e kostos marxhinale gjithë vlerën e ShPP-së fikse e trajton si kosto të periudhës në totalin e kostos së përgjithshme (në pasqyrën e fitimit dhe humbjes).

Formula: Dallimi në fitimet aktuale = Stoqet përfundimtare të PG × ShPP e buxhetuar fikse për njësi
 = 500 njësi × €2.00
 = **€1,000**

2 pikë

Problemi 4

Kompania 'Artizani' bënë prodhimin e stolive të ndryshëm nga ari, argjendti dhe bronzi. Komiteti Olimpik Ndërkombëtar (KON) për Lojërat Olimpike dimërore 2022 ka kërkuar nga kompania 'Artizani' koston e përgjithshme për punimin/prodhimin e 63 kompleteve të medaljeve olimpike që do të shpërndahen 4 garuesve më të mirë për 63 garat e parapara sipas programit. Një komplet duhet të përmbajë një medalje të arit, një medalje të argjendit dhe dy medalje të bronzit që do të thotë se për të përmbushur kërkesën/porosinë gjithsej duhet të punohen/prodhohen 252 medalje (63 të arit + 63 të argjendit + 126 të bronzit).

Për prodhimin e medaljeve kompania përdor tri lloje të materialeve direkte (duhet shkruar dhe përzier disa metale për të përfituar/përgatitur llojet e legurave për secilin lloj të medaljeve).

Procesi i punës zhvillohet nga dy njësi punonjësish. Njësia e parë (shkrirësit) janë punëtor të cilët e bëjnë përgatitjen e materialeve, për të cilët nuk kërkohet përvojë e punës, ndonjë kualifikim apo shkathtësi specifike andaj edhe punësohen sipas nevojës. Njësia e dytë (filigranët) janë punëtor të përhershëm të cilët janë specialist me shkathtësi të larta në prodhimin e stolive.

Pas prodhimit të 'kompletit prototip' të bërë sipas kërkesave të porositesit është përgatitur kartela e koston me të dhënat në vazhdim:

Materialet:			
Materiali A	0.10 kg.	€120.00	€12.00
Materiali B	0.12 kg.	€75.00	€9.00
Materiali C	0.25 kg.	€40.00	€10.00
Puna direkte:			
Shkrirësit	2.00 orë	€4.00	€8.00
Filigranët	8.00 orë	€15.00	€120.00
ShPP variabile (2 orë + 8 orë)	10.00 orë	€3.00	€30.00
Kosto totale e 'kompletit prototip'			€189.00

Kompania 'Artizani' planifikon që 'kompletin e parë prototip të katër medaljeve' ta mbajë për ekspozim reklamues të kompanisë dhe kërkon nga kontabilisti i saj menaxherial të përgatitë vlerësimin e koston për porosinë prej 63 kompleteve me gjithsej 252 medalje duke e këshilluar që të merr parasysh efektin prej 80% të normës së të mësuarit për pjesën e punës së 'filigranëve'.

Kërkohet:

- Llogaritni koston e përgjithshme të vlerësuar për porosinë e KON duke marrë parasysh se 'filigranët' do t'i nënshtrohen normës së të mësuarit prej 80%. **Shënim:** Keni parasysh se numri total i kompleteve që duhet punuar (së bashku me 'kompletin prototip') është 64 komplete respektivisht 256 medalje. Të përdorën deri në 4 decimale. **12 pikë**
- Cilat kosto janë të ndikuara nga lakorja e të mësuarit? Për secilën kosto të listuar të shpjegohet efekti i ndikimit të lakores së të mësuarit. **6 pikë**
- Për çfarë mund të përdoret lakorja e të mësuarit? Të tregohen së paku dy përdorime. **2 pikë**

Zgjidhja

a. Përdorimi i qasjes tabelore në llogaritjen e normës së të mësuarit

- Sqarime ndihmëse:

- Ashtu si është cekur në kërkesën e detyrës ‘numri total i completeve që duhet punuar (së bashku me ‘kompletin prototip’) është 64 complete respektivisht 256 medalje’ që e plotëson kushtin e se ‘Qasja tabelore mund të përdoret për të llogaritur kohën mesatare vetëm kur output-i në kumulativ dyfishohet’. Gjithashtu duhet patur kujdes që grupi i parë prej 4 medaljeve përjashtohet nga porosia si dhe kostoja e përgjithshme e grupit të parë gjithashtu përjashtohet;
- Në kërkesë e detyrës është theksuar se ‘filigranët’ do t’i nënshtrohen normës së të mësuarit prej 80%, andaj shkalla e të mësuarit prej 80% vlen vetëm për ‘filigranët’ dhe ShPP-në e ndërlidhur me orët e PD së ‘filigranëve’, ndërsa për ‘shkrirësit’ dhe ShPP-në e ndërlidhur me orët e PD të ‘shkrirësve’ nuk vlen.

<u>Grupi</u>	<u>Numri kumulativ i njësive</u>	<u>Mesatarja e kohës kumulative për njësi (orë)</u>	<u>Koha totale kumulative (orë)</u>
<u>a¹</u>	<u>b²</u>	<u>c = (↑c) × 80%</u>	<u>d = a × c</u>
1	4	8	8
2	8	6.4	12.8
4	16	5.12	20.48
8	32	4.096	32.758
16	64	3.2768	52.4288
32	128	2.62144	83.88608
64	256	2.097152	134.217728

¹ Grupi është duke u **dyfishuar** secilën herë.

6.5 pikë

² Njësitë e prodhuara (Output-i) është duke u **dyfishuar** secilën herë.

- Llogaritja e koston së përgjithshme për 63 grupe (252 medalje)

Materialet:		
Materiali A	€12 × 64 grupe	768.0000
Materiali B	€9 × 64 grupe	576.0000
Materiali C	€10 × 64 grupe	640.0000
Puna direkte:		
Shkrirësit	2 orë × €4 × 64 grupe	512.0000
Filigranët	134.217728 orë × €15	2,013.2659
ShPP variabile:		
Shkrirësit	2 orë × €3 × 64 grupe	384.0000
Filigranët	134.217728 orë × €3	<u>402.6532</u>
Kostoja e përgjithshme për 64 grupet (256 medaljet)		5,292.9191
minus: Kosto e ‘kompletit prototip’		<u>189.0000</u>
Kostoja e përgjithshme për 63 grupet (252 medaljet)		5,106.9191

5.5 pikë

b. Kostot e ndikuara nga lakorja e të mësuarit

- Lakorja e të mësuarit mund të ndikojë në:
 - *Kohën dhe kostot e punës direkte* - duke e zvogëluar kohën për prodhimin e secilës njësi shtesë, ulet edhe kostoja e prodhimtarisë e PD.
 - *ShPP-në variable* - nëse ato janë të ndërlidhura me PD dhe ndryshojnë me ndryshimin e orëve të punës direkte.
 - *Koston e materialeve* - kostot e MD zakonisht nuk janë të prekura nga të mësuarit e forcës së punës, edhe pse është e mundshme që përdorimi i materialeve mund të përmirësohet dhe kështu kostot e humbjeve të zvogëlohen.
 - *ShPP-në e përgjithshme fikse* - gjithashtu edhe kostot e ShPP-së duhet të jetë të pandikuara nga lakorja e të mësuarit edhe pse në përdorimin e kostos përvetësuese, nëse më pak kohë nevojitet për të prodhuar një njësi të output-it, kur punohet me kapacitet të plotë, ShPP fikse e përvetësuar për njësi do të zvogëlohen sa më shumë njësi të prodhohen.

$4 \times 1.5 = 6$ pikë

c. Përdorimi i lakores së të mësuarit

- Lakorja e të mësuarit mund të përdoret për të:
 - llogaritur koston marginale (shtesë) të bërjes së njërive shtesë të një produkti.
 - bërë caktimin e çmimeve të shitjes për një kontratë, ku çmimet janë llogaritur sipas kostos plus një përqindje e marzhës së fitimit. Një njohuri mbi lakoren e të mësuarit mund të bëjë gjithë dallimin mes fitimit të kontratave dhe humbjes së tyre, apo mes të gjenerimit të fitimeve dhe shitjes me çmime të cilat krijojnë humbje.
 - përgatitur buxhete reale të prodhimtarisë dhe programe më efektive të prodhimtarisë.
 - përgatitur kosto standarde reale për nevojë të kontrollit të kostove etj.

$maksimum\ 2 \times 1 = 2$ pikë

Problemi 5

Kompania 'InFis' bënë prodhimin e produktit DEF (Diesel exhaust fluid) të njohur edhe me emërtimin AdBlue, tretje e cila përdoret për të reduktuar sasinë/nivelin e ndotjes së ajrit të krijuar nga motorët që përdorin si lëndë djegëse Diesel-in.

Divizioni i Prodhimtarisë (DP) i kompanisë 'InFis' me një kapacitet të përgjithshëm mujor të prodhimtarisë prej 1,000 ton bënë shitjen e Produktit DEF në cisterna, tregtareve të jashtëm si dhe Divizionit Komercial (DK) – divizion i brendshëm me rrjetin të pompave të karburantit anëmbanë vendit të cilët Produktin DEF të blerë me shumicë nga DP e ripaketojnë në enë plastike nga 5 litra të cilat i shet përdoruesve të fundit me çmimin prej €8.50 për paketim.

Shitjet mujore të DP-së në tregun e jashtëm janë 500 ton ndërsa shitjet e brendshme janë 300 ton. Çmimi i shitjes si për shitjet e jashtme ashtu edhe për shitjet e brendshme është €500 për ton.

Menaxhmenti i DK kërkon nga menaxhmenti i DP ulje të çmimit në €430 për ton. Me këtë çmim të transferit DK do të jetë në gjendje të shtojë shitjet në 100,000 paketime nga 5 litra në muaj me çmim të 'ri-shikuar' të shitjes prej €6.00 për paketim.

Të dhënat tjera që lidhen me kostot e divizioneve DP dhe DK janë:

	<i>DP</i>	<i>DK</i>	
Kosto variabile për ton	€200	€175	kosto e ripaketimit
Kosto fikse mujore	€120,000	100,000	

Kërkohet:

- a. Llogaritni fitimin mujor të secilit divizion dhe kompanisë si tërësi sipas çmimit të transferit prej €500 dhe €430. **10 pikë**
- b. Bazuar në rezultatet nga pika (a.) komentoni si ndikon ulja e çmimit të transferit nga €500 në €430 për secilën divizion, (marr parasysh edhe çmimin e 'rishikuar' të DK për shitjen e paketimit prej 5 litrave) dhe kompaninë si tërësi. **3 pikë**
- c. Nëse Departamenti Komercial (DK) do të mbajë fitimin në nivelin e njëjtë me vlerën e fitimit të realizuar në pikën (a.) sa duhet të jetë:
 - i. çmimi i 'rishikuar' i shitjes së paketimit prej 5 litra nëse vendoset çmimi i transferit në vlerë prej €430 për ton dhe **3 pikë**
 - ii. çmimi i transferit nëse vendoset çmimi i 'rishikuar' i shitjes së paketimit prej 5 litra në vlerë prej €6.00. **4 pikë**

Zgjidhja

a. Llogaritni fitimin mujor të secilit divizion dhe kompanisë si tërësi

Alternativa I: - Çmimi i transferit €500 për ton

	<u>Divizioni i Prodhimit (DP)</u>	€
Shitjet e jashtme	500 ton × €500	250,000
Shitjet e brendshme	300 ton × €500	<u>150,000</u>
Gjithsej shitjet		400,000
Shpenzimet variabile	800 ton × €200	<u>160,000</u>
Kontributi		240,000
Shpenzimet fikse		<u>120,000</u>
Fitimi		120,000
		2 pikë

	<u>Divizioni Komercial (DK)</u>	€
Shitjet (300 ton = 300,000 litra)	(300,000 lit. ÷ 5 lit.) × €8.5	510,000
Kosto e blerjes nga DP	300 ton × €500	150,000
Kosto variabile e ripaketimit	300 ton × €175	<u>52,500</u>
Kontributi		307,500
Shpenzimet fikse		<u>100,000</u>
Fitimi		207,500
		2 pikë

	<u>Kompania 'InFis' si tërësi</u>	€
Fitimi i Divizioni i Prodhimit (DP)		120,000
Fitimi i Divizionit Komercial (DK)		<u>207,500</u>
Fitimi gjithsej		327,500
		1 pikë

Alternativa II: - Çmimi i transferit €430 për ton

	<u>Divizioni i Prodhimit (DP)</u>	€
Shitjet e jashtme	500 ton × €500	250,000
Shitjet e brendshme	500 ton × €430	<u>215,000</u>
Gjithsej shitjet		465,000
Shpenzimet variabile	1,000 ton × €200	<u>200,000</u>
Kontributi		265,000
Shpenzimet fikse		<u>120,000</u>
Fitimi		145,000
		2 pikë

	<u>Divizioni Komercial (DK)</u>	€
Shitjet (500 ton = 500,000 litra)	(500,000 lit. ÷ 5 lit.) × €6	600,000
Kosto e blerjes nga DP	500 ton × €430	215,000
Kosto variabile e ripaketimit	500 ton × €175	<u>87,500</u>
Kontributi		297,500
Shpenzimet fikse		<u>100,000</u>
Fitimi		197,500
		2 pikë

<u>Kompania 'InFis' si tërësi</u>		€
Fitimi i Divizioni i Prodhimit (DP)		145,000
Fitimi i Divizionit Komerical (DK)		<u>197,500</u>
Fitimi gjithsej		342,500
		1 pikë

b. Ndikimi i uljes së çmimit të transferit nga €500 në €430 për secilën divizion dhe kompaninë

- Edhe pse ka rritje në vëllimin e shitjeve në Divizionin Komerical (nga 300 ton në 500 ton respektivisht nga 60,000 paketime në 100,000 paketime 5-litërsh), ulja e çmimit të shitjes (nga €8.5 në €6.0 për një paketim 5-litërsh) e zvogëlon performancën e këtij divizioni sepse fitimi i divizionit zvogëlohet për €10,000 d.m.th. nga €207,500 në €197,500.
- Me uljen e çmimit për shitjet e brendshme (nga €500 në €430) performanca e Divizionit të Prodhimit shënon ngritje meqenëse me shtimin e prodhimtarisë dhe shfrytëzueshmërisë së plotë të kapaciteteve nuk ka asnjë kosto fikse shtesë. Fitimit e këtij divizioni rriten për €25,000 d.m.th. shkojnë nga €120,000 në €145,000.
- Nga këndvështrimi i Kompanisë 'InFis' si tërësi e gjithë kjo do të rezultojë me përmirësim të konsiderueshëm të performancës së saj me rritje të fitimit të përgjithshëm për €15,000 (nga €327,500 në €342,500), andaj duhet pranuar propozimin e Divizionit Komerical për uljen e çmimit të transferit nga €500 në €430. **3 × 1 = 3 pikë**

c.

i. Çmimi i 'rishikuar' i shitjes së paketimit prej 5 litra (nëse çmimi i transferit është €430)

<u>Divizioni Komerical (DK)</u>		€
Fitimi i synuar		207,500
Shpenzimet fikse		<u>100,000</u>
Kontributi		307,500
Kosto variabile e ripaketimit	500 ton × €175	87,500
Kosto e blerjes nga DP	500 ton × €430	<u>215,000</u>
Niveli i të hyrave nga shitjet		610,000
Numri i njësisve të shitjes (paketime)		<u>100,000</u>
Çmimi i nevojshëm i shitjes		6.10

Çmimi i shitjes për një paketim 5 lit. duhet të jetë **€6.10**

3 pikë

ii. Çmimi i 'rishikuar' i transferit (nëse çmimi i shitjes për një paketim 5 lit. është €6.00)

<u>Divizioni Komerical (DK)</u>		€
Fitimi i synuar		207,500
Shpenzimet fikse		<u>100,000</u>
Kontributi		307,500
Kosto variabile e ripaketimit	500 ton × €175	<u>87,500</u>
Kostot totale pa kostot e blerjes		395,000
Niveli i të hyrave nga shitja	100,000 paketime × €6	<u>600,000</u>
Kostoja e blerjes së brendshme	€600,000 – €395,000	205,000
Vëllimi i materialeve të blera		<u>500</u>
Çmimi i 'rishikuar' i transferit		410

Çmimi i 'rishikuar' i transferit duhet të jetë **€410**

4 pikë